



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E  
MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 733/prot.

Tiranë, më 08. 11.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1774, datë 03.11.2015.

**SHOQËRISË "MAXI" SH.P.K  
Fshati Vaqarr, Sharrë, Tiranë.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE  
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE  
EMERGJENCAT NË MINIERA  
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria "Maxi" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1774, datë 03.11.2015, për mineral ranor silicor, në objektin "Vranisht", Vlorë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.408 prot., datë 10.01.2018, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr.733 prot., datë 12.01.2018, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1774, datë 03.11.2015, për mineral ranor silicor, në objektin "Vranisht", Vlorë, për arsye se nuk ka filluar puna akoma në objektin për të cilën shoqëria juaj është pajisur me leje, duke shkelur afatet e përcaktuara, në Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar dhe aktet nënligjore që kane dalë në zbatim të tij.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në paragrafi "ii", të germës "b", të pikës 1, neni 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1774, datë 03.11.2015, për mineral ranor silicor, në objektin "Vranisht", Vlorë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1774, datë 03.11.2015, për mineral ranor silicor, në objektin “Vranisht”, Vlorë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

**MINISTRI**

**DAMIAN GJIKNURI**

**ME AUTORIZIM**

**ZËVENDËSMINISTRI**

**ENIS ALIKO**

